



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me nr. 09-4111/1 të datës 21.04.2022 të dorëzuar kundër personit ///, drejtor i /// Shkup, në lidhje me nenin 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se pretendimet nga kërkesa janë të vërtetuara, tek personi i panjohur është konstatuar shkelje e dispozitave të LPKKI-së, sepse me rastin e emërimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit të shkollës së përmendur, personi /// nuk ka paraqitur formularin e deklarimit të interesave dhe fletën anketuese, por për shkak të vjetërsimit të kundërvajtjes sipas Ligjit për Kundërvajtje, procedura e zgjidhjes nuk mund të zbatohet në përputhje me nenin 114 paragrafi 3 të LPKKI-së, dhe për shkak të kësaj, KSHPK-ja nuk ka mundësi ligjore për të marrë masa për veprime të mëtutjeshme në rastin konkret.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 09-4111/1 të datës 21.04.2022 është formuar në bazë të denoncimit nga një parashtrues i njohur kundër personit ///, drejtor i ///.

Gjegjësisht, në denoncim thuhet se personi ///mban detyrën e drejtorit që nga data 25.06.2018, por për këtë person nuk ka të dhëna në Regjistrin e Personave të Zgjedhur/Emëruar të Komisionit Shtetëror, pas së cilës parashtruesi. kërkon të kontrollojë nëse personi ka paraqitur deklaratë të gjendjes pasurore dhe interesave dhe të njoftohet përsëri.

Gjatē kontrollit nē Regjistrin Qendror tē RMV-sē, ēshtē konstatuar se personi /// ēshtē emēruar ushtrues detyre nga data 29.10.2018 me Vendimin /// tē ///, por me datē 06.11.2019 me/// ēshtē emēruar drejtor i kēsaj shkolle nga kryetari i Qytetit tē Shkupit.

Gjithashtu, KSHPK-ja ka inspektuar regjistrat e deklaratave tē dorēzuarat tē interesit nē njēsiniē e parandalimit tē konfliktit tē interesit dhe lobimit dhe evidencēn e pyetēsorēve tē dorēzuar nē njēsiniē e monitorimit tē gjendjes pasurore dhe interesave, dhe ka konstatuar se personi i specifikuar nuk e ka dorēzuar formularin e deklaratēs sē interesit dhe fletēn anketuese pēr ushtruesin e detyrēs sē drejtorit, por ēshtē dorēzuar pēr drejtor, brenda 30 ditēve pas emērimit.

Nga tē gjitha sa mē sipēr, rezulton se Komisioni Shtetēror nuk mund tē zbatojē procedurēn e zgjidhjes nē pērputhje me nenin 114 paragrafi 3 tē LPKKI, sepse ky akt ēshtē i vjetruar sipas Ligjit pēr kundērvajtje, dhe pēr rrjedhōjē KSHPK-ja nuk ka mundēsi ligjore pēr tē marrē masa pēr veprime tē mētejshme pēr lēndēn konkrete.

Duke pasur parasysh tē theksuarēn mē sipēr, Komisioni Shtetēror nuk ka elemente pēr veprime kompetente, prandaj u vendos si nē dispozitēn e kētij vendimi.

KOMISIONI SHTETĒRORE
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nēnkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev

Sipas pērfundimit tē KSHPK-sē,
Pērgatiti: B.XH. - Kēshilltar
Kontrolloji: K.Z., Udhēheqēsē